

Qytetari

1 pike

1. Kodet janë grupim ligjesh të llojeve të ndryshme sepse mbulojnë:

- A) kohë të ndryshme,
- B) vende të ndryshme,
- C) penaltete të caktuara,
- D) marrëdhënie të caktuara.

2. Estonia renditet ndër shtetet me politikat më të mira për nënat. Gratë, pas lindjes së foshnjave, përfitojnë nga shteti lejon 85 javore me pagesë të plotë. Ligji në këtë rast ka vlerë:

- A) politike.
- B) sociale.
- C) ndërkombëtare.
- D) ekonomike kombëtare.

3. Pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor nuk duhet të ndikohen dhe as t'i nënshtrohen njëri-tjetrit. Organi i një pushteti nuk duhet të ushtrojë funksionet e organeve të pushteteve të tjera. Parimi i kushtetutës në këtë rast është:

- A) sovraniteti i shtetit.
- B) paqja dhe interesi kombëtar.
- C) barazia e të gjithëve përpara ligjit.
- D) ndarja dhe ekuilibrimi i pushteteve.

4. Pavarësisht klasifikimit të kushtetutave në të ngurta dhe elastike, ndryshimet e tyre ndodhin si rezultat i:

- A) vendimit të juristëve në vend.
- B) vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
- C) proceseve dinamike në shoqëri.
- D) interesit të Presidentit të vendit.

5. Një grup qytetarësh organizuan një protestë për pasigurinë e rruqes së të dhënave online. Protestuesit ishin të shumtë në numër dhe për shkak të masave të sigurisë ndaj Covid-19, policia kërkoi shpërndarjen e tyre. Të indinjuar ata deklaruan se policia po cenonte të drejtën e tyre.

1 pike

a) Në këtë situatë qytetarët mendojnë se veprimi i policisë po cenon të drejtën e kategorisë (të brezit) së: _____

2 pike

b) Mbari qëndrim pro ose kundër veprimit të policisë duke argumentuar përgjigjen. _____

6. Në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 8 përcakton: "Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike". Në rastin e rrezikut nga terrorizmi si dhe në periudhën e pandemisë, u kufizuan disa të drejta. Shpjegoni dy arsye në të cilat justifikohet kufizimi i këtyre të drejtave.

2 pike

1) _____

2) _____

7. Në shkollën tonë, nxënësit e klubit të vullnetarëve realizojnë së bashku çdo aktivitet social. Prezantimet i bëri Arbana sepse ka oratorinë e duhur. Albani është diagnostikuar me çregullim të spektrit të autizmit. Ai pikturon bukur, ndaj realizon vizatimet për çdo rast. Klubi është në katin e parë pasi aty ka një rampë për Gentën, që është në karrige me rrota. Ajo harton kalendarin e aktivitetëve. Bazuar në shembullin e dhënë shpjegoni dy funksione të shkollës. 2 pike

1) _____

2) _____

8. Në fushën e mjekësisë vlon parimi: "Të parandalosh është më mirë se të kurosh". Shpjegoni dy arsye që tregojnë rëndësinë e parandalimit të sëmundjeve. 2 pike

1) _____

2) _____

9. Shëndeti i njeriut përfshin disa dimensione si atë fizik, shoqëror dhe mendor. Cila nga alternativat e mëposhtme lidhet me aspektin shoqëror të shëndetit të njeriut? 1 pike

- A) Emocionet dhe vlerat shpirtërore.
- B) Peshat normale dhe mirëqenia fizike.
- C) Sëmundjet infektive dhe kequshqyerja.
- D) Sjellja tolerante dhe miqësore me të tjerët.

10. Cili pohim është i vërtetë për zhvillimin e qëndrueshëm? 1 pike

- A) Model që plotëson vetëm nevojat e tanishme.
- B) Model zhvillimi që garanton nevojat e brezave të ardhshëm.
- C) Model që nuk plotëson nevojat bazike të njerëzve.
- D) Model zhvillimi që nuk përdor burime të rinovueshme.

11. Vendimi për të zgjatur moratoriumin e gjuetisë erdhi si rrjedhojë e efekteve pozitive nga masat e marra, ku u konstatua rritje e ndjeshme e numrit të shpendëve të egër. Qëllimi është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër. Cili nga objektivat e mbrojtjes së mjedisit lidhet me këtë situatë? 1 pike

- A) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit.
- B) Përdorimi i burimeve natyrore sipas kërkesës për të plotësuar nevojat.
- C) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.
- D) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së burimeve ujore dhe ajrit.

12. Në ofertat e festave të fundvitit, Erlisi bleu një telefon celular me ulje çmimi dhe me garanci dyvjeçare. Menjëherë pasi e hapi, produkti rezultoi me një defekt fabrikimi. Shpjegoni tre mundësitë e përfitimit që rrjedhin nga garancia kontraktuale në këtë rast. **3 pikë**

- 1) _____
- _____
- 2) _____
- _____
- 3) _____
- _____

13. Edliri 15 vjeçar, si i vetmi sigures i të ardhurave familjare, i duhej të punonte çdo ditë rreth 9 orë në grumbullimin e kromit në Bulqizë, me shpresën për të siguruar sadopak të ardhura. Ky aktivitet realizohej në një zonë ku aksidentet me pasoja të rënda dhe fatale ishin të shumta. Edliri kishte braktisur shkollën për shkak se punonte me orar të zgjatur. Argumentoni pasojat e kësaj pune në këtë rast. **3 pikë**

- 1) Pasoja fizike _____
- _____
- 2) Pasoja sociale _____
- _____
- 3) Pasoja psikologjike _____
- _____

14. Njohja dhe zbatimi i normave të Kodit Rrugor dhe akteve në zbatim të tij janë të detyrueshme vetëm për: **1 pikë**

- A) këmbësorët.
- B) drejtuesit e mjeteve.
- C) përdoruesit e rrugës.
- D) përdoruesit e biçikletave.

15. Kodi Rrugor është dokumenti më i rëndësishëm ligjor për çështjet e sigurisë rrugore. Ai udhëhiqet nga parimi i: **1 pikë**

- A) ndëshkueshmërisë.
- B) përdorimit të energjisë.
- C) shfrytëzimit të mjeteve të lëvizjes.
- D) sigurisë së lëvizjes në rrugë.

16. Ermira priti ditën jeshile të semaforit për të kaluar kryqëzimin, por ajo u step kur pa makinat të vinin në drejtim të saj. Në kryqëzim qëndronte polici i trafikut që rregullonte qarkullimin me duar dhe tabelë. **2 pikë**

- a) Tregoni nëse ka të drejtë ose jo të kalojë Ermira.

- b) Shpjegoni përgjigjen tuaj.

17. Mjetet e informimit publik kanë një rëndësi dhe ndikim të madh në shoqëri, ndaj media njihet si "pushtet i katërt". Përcaktoni tre funksione që realizojnë mjetet e informimit publik. 3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

18. Administratori i pallatit deklaron se nuk ka fond për rregullimin e shkallëve të prishura, pasi banorët e apartamenteve të dhëna me qira nuk paguajnë tarifën e administrimit. Në këto kushte këtë tarifë e paguajnë vetëm pak familje. Për këtë rast, sipas legjislacionit vlen të thuhet se: 1 pikë

- A) apartamentet me qira kanë detyrim pagesën e tarifës së administrimit.
- B) apartamentet me qira nuk kanë detyrim pagesën e tarifës së administrimit.
- C) kontrolli i shkallëve nuk është përgjegjësi e administratorit të pallatit.
- D) nuk është detyrë e administratorit të pallatit mbajtja e buxhetit për riparime.



Matura Shtetërore 2023
matura.shtetërore

Lënda: Qytetari dhe Psikologji

Psikologji

19. Një nga drejtimet e studimit të psikologjisë është bhejviorizmi, me themelues Xhon Uatsonin. Përcaktoni tre aspekte të këtij drejtimi. 3 pike
- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
20. Aftësia për të perceptuar, kuptuar, menaxhuar emocionet dhe për ta përdorur këtë informacion në marrjen e vendimeve për të tejkaluar sfidat, përcaktohet nga psikologët si: 1 pikë
- A) altruizëm.
B) strategji.
C) motivacion.
D) inteligjencë emocionale.
21. Hemisferat e trurit të njeriut, megjithëse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, janë të specializuara në kryerjen e disa funksioneve të veçanta. Konkretisht, hemisfera e djathtë merret me: 1 pikë
- A) gjuhën dhe matematikën.
B) aspektet artistike dhe krijuese.
C) reagimin automatik të receptorëve.
D) nxitjen dhe frenimin e sistemit metabolik.
22. Hipofiza, gjëndra sa një kokërr bizele, që ndodhet në trurin e njeriut pranë hipotalamusit, prodhon hormone shumë të rëndësishme për organizmin tonë, që janë përgjegjëse për: 1 pikë
- A) funksionimin normal të indeve dhe muskujve.
B) stimulimin e prodhimit të aminoacideve tretëse.
C) përgatitjen e reagimeve ndaj mjedisit të jashtëm.
D) kontrollin e metabolizmit, rritjen dhe zhvillimin seksual.
23. Erblini është admirues i hedhjes me parashutë. Pas disa seancave trajnuese, ai vendosi të realizonte hedhjen e tij të parë, edhe pse disi i frikësuar. 1 pikë
- a) Përcaktoni cili është hormoni që sekretohet në këto momente. 1 pikë
- _____
- b) Shpjegoni çfarë ndodh në gjëndrën mbiveshkore (adrenale). 2 pikë
- _____
- _____
- _____
24. Stresorët janë pjesë e përditshmërisë dhe ndikojnë në fizikun dhe psikologjinë tonë. Shpjegoni dy grupe të tjerë stresorësh, përveç *ndryshimeve jetësore*. 2 pikë
- 1) _____
- _____

25. Elira është pjesë e konkursit ndërkombëtar të ligjërimit publik. Ajo po përgatitet për prezantim, por ndihet shumë e stresuar, ndonëse ka edhe një javë kohë. Marrja e një çmimi në konkurs do ta ndihmojë për të përfituar një bursë studimi. Argumentoni dy elemente ndihmues për Elirën që të përballojë stresin, referuar strategjive ndihmëse. **2 pike**

- 1) _____

- 2) _____

26. Imazhi që kemi për veten është shumë i rëndësishëm, sepse përcakton sjelljen tonë dhe bashkëveprimin me të tjerët. Shpjegoni dy mënyra, që shërbejnë për të përmirësuar vetëvlerësimin. **2 pike**

- 1) _____

- 2) _____

27. Albi është nxënës i klasës së dytë. Ai e pëlqen lëndën e matematikës dhe mund t'i kryejë pa vështirësi mbledhjet dhe zbritjet. Sipas psikologut Zhan Piazhe, Albi ndodhet në stadin e zhvillimit: **1 pike**

- A) sensomotor.
B) paraoperacional.
C) operacional formal.
D) operacional konkret.

28. Blerta është një vajzë e qeshur. Ajo përcjell gjithmonë emocione pozitive dhe ka marrëdhënie shumë të mira me shokët dhe shoqet e klasës. Blerta i përket tipit të personalitetit: **1 pike**

- A) kolerik.
B) sanguin.
C) flegmatik.
D) melankolik.

29. Marrëdhënia me të tjerët luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin emocional dhe social të fëmijës, që i vlen atij gjatë gjithë jetës. Analizoni ndikimin e dy faktorëve të mëposhtëm për një jetë sociale të shëndetshme të tij në të ardhmen. **2 pike**

- a) Ndërveprimi me të riturit _____

- b) Ndërveprimi me bashkëmoshatarët _____

30. Ëndrrat janë një seri imazhesh, emocionesh, mendimesh dhe ndjesish të pavullnetshme, që iu shfaqen të gjithëve gjatë kohës së gjumit. Përshkruani tri karakteristika të ëndrrave, sipas psikologëve. **3 pike**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

Lenda: Qytetari dhe Psikologji

31. Besa dhe Joni kanë organizuar një guidë për turistët që do të vizitojnë Shkodrën. Të dy japin informacione mbi ngjarjet historike dhe nënkulturën e vendit. Ata kanë të memorizuar distancat, ndaj informojnë saktë turistët se kur do të ndodhen në pika të caktuara të qytetit dhe rrethinave. Për Besën dhe Jonin këto informacione lidhen me kujtesën: **1 pikë**
- A) shqisore.
B) episodike.
C) semantike.
D) afatshkurtër.
32. Pas një aksidenti automobilistik, Arba nuk mbante mend asgjë për të shkuarën e saj. Në këtë rast kemi të bëjmë me amnezinë: **1 pikë**
- A) retrograde.
B) anterograde.
C) represive.
D) e motivuar.
33. Ani është 20 muajsh dhe sapo ka filluar të thotë togfjalëshat e parë. Sa herë që familjarët e dëgjojnë, buzëqeshin dhe me intonacion entuziast i thonë: "Bravo!". Ani vrapon me gëzim dhe përsërit sërish fjalët. Kjo situatë lidhet me: **1 pikë**
- A) përforcimin parësor.
B) kushtëzimin e ikjes.
C) kushtëzimin shmangës.
D) përforcimin e kushtëzuar.
34. Kampioni i tenisit prezantoi një linjë të re veshjeje sportive mjaft moderne, në aktivitetin ku ishte ftuar. Ai deklaroi se paratë e mbledhura nga shitjet do të shkonin për bamirësi. Kaq mjaftoi për të motivuar gjithë pjesëmarrësit që të blinin veshjet sportive, edhe pse nuk e kishin parashikuar këtë shpenzim. Në këtë rast kemi të bëjmë me: **1 pikë**
- A) kompliancën.
B) paragjykimin.
C) efektin e spektatorit.
D) represionin.
35. Veçimi, trajtimi jo i barabartë dhe disavantazhues i anëtarëve të një grupi të caktuar, përcaktohet nga studiuesit si: **1 pikë**
- A) stereotip.
B) diskriminim.
C) paragjykim.
D) qëndrim pozitiv.
36. Bora punon si mësuese në fshatin ku banon. Pas vendimit të saj për t'u angazhuar politikisht si kandidate në zgjedhjet lokale, as familjarët e as miqtë nuk e mbështetën, duke e konsideruar këtë punë burrash, sepse kanë aftësi në drejtim. Ata mendojnë se puna si mësuese është më e përshtatshme për një grua. Mediat lokale, duke pasur të njëjtën mendësi nuk e ftuan asnjëherë në emisione përgjatë fushatës elektorale. Për situatën e dhënë:
- a) Përcaktoni formën e sjelljes së medias. _____ **1 pikë**
- b) Argumentoni dy elementë përbërës të qëndrimit të medias për këtë rast. **2 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____